

2. ZHVILLIMET EKONOMIKE DHE FINANCIARE NDËRKOMBËTARE

(6) Gjatë periudhës, zgjerimi i aktivitetit ekonomik botëror është moderuar.

Maturimi i ciklit të ekonomisë globale, zbehja e efekteve të politikave ekonomike mbështetëse në vendet e zhvilluara dhe përdorimi i tarifave si instrument në trajtimin e mosmarrëveshjeve tregtare mes ekonomive më të mëdha të botës, kanë pasur efekt negativ në rritjen e tregtisë dhe të ekonomisë globale. Kushtet në tregjet financiare të rajoneve të zhvilluara janë shtrënguar disi gjatë muajve të fundit të vitit, duke reflektuar shqetësimet mbi përshkallëzimin e tensioneve tregtare dhe pritjet për ngadalësim të rritjes ekonomike. Në tregjet financiare të rajoneve në zhvillim, dinamikat e zhvillimeve kanë qenë të ndryshme, ndërkohë që vendet me struktura të dobëta makroekonomike dhe klimë politike të pasigurt janë karakterizuar nga rritje e presioneve financiare. Presionet inflacioniste globale kanë mbetur të ndrydhura, duke reflektuar rënien e çmimeve të naftës, por pritjet të rriten gradualisht si rezultat i shterimit të kapaciteteve të lira në ekonominë globale. Aktiviteti ekonomik botëror pritjet të vijojë të dobësohet më tej gjatë 2019 dhe të stabilizohet në dy vitet që do të pasojnë.

(7) Shumica e vendeve anëtare të Eurozonës kanë regjistruar rritje ekonomike vjetore pozitive, por ritmi i rritjes është ngadalësuar gjatë dy tremujorëve të fundit të vitit 2018.

Aktiviteti ekonomik është mbështetur nga forcimi i kërkesës së brendshme, ndërkohë që aktiviteti tregtar ka dhënë kontribut negativ. Kushtet në tregun e punës kanë vijuar të përmirësohen në shumicën e vendeve të Eurozonës dhe punësimi është rritur përtej nivele të parakrizës. Si rezultat, norma e papunësisë së këtij rajoni ra në 7.9% në fund të vitit 2018, duke shënuar vlerën më të ulët që nga tetori i vitit 2008. Presionet inflacioniste u dobësuan në muajt e fundit të vitit, ndikuar nga rënia e çmimeve të naftës dhe produkteve ushqimore. Në këto kushte, Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka vijuar të ruajë politikën monetare lehtësuese, ndonëse programi i lehtësimit sasior përfundoi në dhjetor të vitit 2018.

(8) Në sektorin bankar evropian, kreditimi ka vijuar të regjistrojë norma pozitive dhe të qëndrueshme rritjeje, ndonëse në nivele të moderuara.

Kjo ecuri është mbështetur nga kushtet ende të favorshme të financimit dhe rritja e kërkesës për kredi në të gjitha kategoritë e saj. Rënia e përgjithshme e normave të interesit të kredisë për të gjithë segmentet e klientelës dhe në shumicën e vendeve të Eurozonës, reflekton një transmetim më uniform të politikës lehtësuese monetare të BQE-së gjatë periudhës.

(9) Rreziqet ndaj perspektivës ekonomike të Eurozonës konsiderohen të moderuara.

Ato lidhen kryesisht me pasigurinë nga zhvillime të caktuara gjeopolitike, rrezikun e forcimit të barrierave tregtare mes vendeve dhe rritjen e luhatshmërisë në tregjet financiare. Nga ana tjetër, kushtet ende të favorshme të



financimit dhe forcimi i kërkesës së brendshme pritet të mbështesin më tej zgjerimin ekonomik të këtij rajoni. BQE-ja ka deklaruar se politikat e saj do të vijojnë të mbeten akomoduese dhe në mbështetje të rritjes ekonomike të Eurozonës.

Tabelë 1. Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në dhe Eurozonën

	Ndryshimi i PBB-së (% vjetore)				Inflacioni (% vjetore)		Papunësia (% vjetore)		Borxhi i qeverisë (% e PBB-së)	
	T3'18	T4'18	2018p	2019p	Shr'18	Dhj'18	Shr'18	Dhj'18	T2'18	T3'18
SHBA	3.4	2.6	2.9	2.5	2.3	1.9	3.7	3.9	103.9	104.2
Eurozonë	1.6	1.1	1.6	1.7	2.1	1.6	8.0	7.9	86.3	86.1
Gjermani	1.2	0.6	1.3	1.6	2.2	1.7	3.3	3.3	61.5	61.0
Francë	1.3	0.9	1.5	1.6	2.5	1.9	9.1	9.1	99.1	99.5
Itali	0.6	0.0	0.6	0.9	1.5	1.2	10.4	10.3	133.1	133.0
Greqi	2.1	1.6	:	:	1.1	0.6	18.6	:	177.4	182.2

Burimi: Banka Qendrore Evropiane, Eurostat, "p"-parashikime (janar, 2019) të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Zyra e Analizave Ekonomike (BEA –Bureau of Economic Analysis). Zyra Amerikane e Statistikave të Punës (U.S. Bureau of Labour Statistics). ":" mungesë informacioni.


(10) Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, aktiviteti ekonomik ka vijuar të zgjerohet, por dinamikat e rritjes kanë qenë të ndryshme nga njëri vend në tjetrin. Në tremujorin e tretë të vitit 2018, ekonomia e rajonit u rrit me 3.7% në nivel vjetor, e mbështetur kryesisht nga rritja e investimeve dhe e konsumit privat. Ritmi i rritjes është ngadalësuar në krahasim me tremujorin paraardhës (rritje prej 4.3%), ndikuar kryesisht nga ulja e normës së rritjes ekonomike në Serbi. Zgjerimi ekonomik ka vijuar të stimulojë krijimin e vendeve të reja të punës, gjë që ka sjellë rënien e papunësisë në të gjitha vendet e rajonit. Pavarësisht ecurisë pozitive, kushtet në tregun e punës vijojnë të mbeten sfiduese dhe normat e papunësisë në nivele dyshifrore. Për shkak të bazës së ulët të prodhimit dhe konkurrueshmërisë së dobët, nivelet e larta të deficitit tregtar mbeten një burim dobësie për të gjitha vendet e rajonit.

(11) Gjatë periudhës, presionet inflacioniste në vendet e rajonit ishin të moderuara dhe bankat qendrore ruajtën një politikë monetare lehtësuese. Kredia për ekonominë ka vijuar të rritet pozitivisht dhe të mbështesë rritjen ekonomike, ndërkohë që rritja më e shpejtë e kredisë për sektorin e familjeve mbetet një karakteristikë e përbashkët e vendeve të rajonit. Niveli i kredive me probleme ka vijuar të bjerë në të gjitha vendet, si rezultat i përmirësimit të kuadrit të trajtimit të tyre dhe fshirjeve të detyruara. Pakësimi në stokun dhe raportin e kredive me probleme ka dhënë efekt pozitiv në kapacitetin kreditues të bankave.

Tabelë 2. Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor

	PBB (reale, % vjetore)			Papunësia (në %)		Borxhi sovran (% e PBB-së)		Rritja e kredisë (% vjetore)		Rap. i kredive me probleme (në %)	
	T2'18	T3'18	2018p	T2'18	T3'18	T2'18	T3'18	T2'18	T3'18	T2'18	T3'18
B-H	3.6	3.0	:	:	35.0*	38.6	37.2	6.8	6.5	9.3	9.4
Maqedoni e Veriut	3.0	3.0	2.1	21.1	20.8	40.3	40.3	6.0	6.8	6.5	6.3
Mal i Zi	2.8	3.1	3.9	14.7	14.4	62.8	61.8	12.8	10.7	7.0	6.7
Kosovë	4.2	4.5	4.1	29.4	30.7	16.9	:	10.8	11.6	2.7	:
Serbi	4.9	3.8	4.4	11.9	11.3	59.7	:	0.3	6.0	7.8	6.4
Shqipëri	4.2	4.7	4.1	12.4	12.2	72.5	72.6	-1.8	-1.6	13.3	12.9


Burimi: Komisioni Evropian, "p"-parashikimi i muajit janar, 2019; ":" mungesë informacioni.



(12) Në tregjet financiare botërore, kushtet e financimit janë shtrënguar disi dhe kanë shfaqur një luhatshmëri më të lartë. Kjo ecuri ka reflektuar paqartësinë mbi zhvillimin e ekonomisë botërore dhe mbizotërimin e pritshmërive për shtrëngimin e politikës monetare të Rezervës Federale. Si rezultat, indekset kryesore të tregjeve të kapitalit kanë shfaqur paqëndrueshmëri dhe *spread*-et e tyre janë zgjeruar. Në tregjet e vendeve në zhvillim, dinamikat kanë qenë më të larmishme dhe të lidhura shpesh me faktorë specifikë. Flukset hyrëse të kapitalit në këto vende janë moderuar ose janë kthyer në negative, për shkak të kushteve më të shtrënguara të likuiditetit në vendet e zhvilluara dhe rritjes së tensioneve tregtare.


(13) Pritjet më pak optimiste për ecurinë e ekonomisë botërore, apo ekonomisë së rajoneve të mëdha, janë reflektuar edhe në ecurinë e tregjeve të tjera. Kështu, në tregjet e këmbimit të monedhave euro ka shfaqur një prirje nënçmuese. Në tregjet e lëndëve të para, çmimet e metaleve dhe të produkteve bujqësore, gjithashtu kanë qenë në rënie gjatë periudhës. Çmimi i naftës është luhatur gjatë gjysmës së dytë të vitit 2018, por prirja rënëse është forcuar në tremujorin e fundit të vitit, duke shënuar nivelin 55-60 dollarë amerikanë për fuçi.

Grafik 7. Ecuria e indekseve kryesore në tregjet e aksioneve



Burimi: Banka Qendrore Evropiane.

Grafik 8. Ecuria e kursit të këmbimit të euros ndaj monedhave të tjera



Burimi: Banka Qendrore Evropiane.

